


# QENDRA E INTERPRETIMIT TË PEISAZHIT ADRILINK

VALBONË SHQIPËRI

**Interreg**   
EUROPEAN UNION  
**ADRION** **ADRIATIC-IONIAN**  
European Regional Development Fund - Instrument for Pre-Accession II Fund

**ADRILINK**



Prej më shumë se dy vitesh, në kuadër të Programit të bashkëpunimit Interreg “ADRION 2014-2020”, Fondi Shqiptar i Zhvillimit po zbaton projektin “ADRILINK - Rrjeti i Interpretimit të Peisazhit në zonën e Adriatikut” në bashkëpunim me partnerë nga 6 vende të përfshira në rajonin e Adriatikut (Itali, Greqi, Kroaci, Slloveni, Bosnjë & Hercegovinë dhe Serbi).

Objektivi i përgjithshëm i projektit ADRILINK është të promovojë Turizmin e Peisazhit në Rajonin e Adriatikut nëpërmjet krijimit të një rrjeti Qendrash të Interpretimit të Peisazhit, të konceptuara si pika nyjesh të shtigjeve dhe rrugëve tematike të zgjedhura, të lidhura në mënyrë dixhitale përmes një platforme digjitale, duke siguruar menaxhimin e integruar të shërbimeve turistike si edhe duke nxitur inovacionin.

Projekti ofron modele të reja të menaxhimit të turizmit të qëndrueshëm që synojnë reduktimin e sezonalitetit të turizmit nëpërmjet valorizimit të peizazheve natyrore dhe kulturore si asete të përbashkëta që mund të vizitohen gjatë gjithë vitit. Duke promovuar aktivitete për vlerësimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore evropiane si shtresë kyçe e mirëqenies njerëzore, projekti kontribuon në forcimin e Identitetit të Rajonit të Adriatikut si destinacion unik turistik. Ai është konceptuar si një "projekt i bazuar në komunitet" ku komuniteti është aktori kryesor në "të menduarit/rimenduarit" e peisazhit të tij, duke përdorur çelësa të ndryshëm interpretues si histori dhe arte, kulturë, zanate, shtigje dhe tradita, tipike për të rindërtuar të kaluarën e vet, të kuptojë të tashmen dhe të planifikojë gjithashtu të ardhmen.



Për të ndihmuar vizitorët të kuptojnë profilin kompleks të zonës, u zhvilluan tema si pjesë e informacionit të ofruar në mënyrë digjitale dhe virtuale. Vlerat e përdorura në interpretim janë kushtet natyrore, kushtet socio-ekonomike si dhe pasuritë e trashëgimisë kulturore. Ndërkohë, zona është padyshim e pasur me vlera natyrore, siç u përmend më lart, por ka edhe një histori të pasur në trashëgimi kulturore materiale dhe jomateriale.

Informacioni interpretohet përmes videove dhe informacioneve audio të përgatitura për një sërë mjesh që përfshijnë ekrane interaktive, komplete VR, tabletë si dhe aplikacione celulare të shkarkueshme nga web ose edhe përmes skanimit të një kodi.

Aktiviteti final i projektit është krijimi i Qendrës së interpretimit të Peisazhit. Qendra e Interpretimit të Peisazhit ndodhet në ambientet e Qendrës së Zhvillimit të Turizmit në Valbonë. Plani i projektimit, funksionimit dhe menaxhimit për Qendrën e Interpretimit të Peisazhit (LIC) bazohet në udhëzimet e zhvilluara nga projekti dhe informacionin konkret të mbledhur gjatë zbatimit të projektit.

